

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXV, nr. 7977  
E shtunë, 25 janar 2025  
Çmimi 0.50 €

25 vjet nga  
themelimi i gazetës  
"Epoka e re" | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## AMBASADORËT E BE-së KONFIRMOJNË SORENSENIN EMISAR PËR DIALOGUN KOSOVË - SERBI | FAQE 4



Ambasadorët e Bashkimit Evropian të premtën e kanë konfirmuar Peter Sorensenin për pozitën e të deleguarit të Bashkimit Evropian për

dialogun Kosovë - Serbi. Sorensen nga 1 shkurti pritet ta zëvendësojë në këtë pozitë Miroslav Lajçakun, mandati i të cilit kalon më 31 janar.

Diplomati danez në këtë pozitë është zgjedhur nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas

TRUMPI THOTË SE DO TË TAKOHEJ MENJËHERË ME PUTININ PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS NË UKRAINË | F.3



KOSOVËS I SHTOHEN 462 POLICË TË RINJ | F.3



ASK-ja PUBLIKON TË DHËNAT PËR TREGTINË E JASHTME: DEFICIT TREGTAR PREJ 17,5 % NË DHJETOR 2024 | F.8

### SPORT



SOT DY NDESHJE, NESËR DERBI PRISHTINA - PEJA | F.10

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 735  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@ml.net.mk](mailto:renova@ml.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Senati konfirmon John Ratcliffe drejtor të CIA-s

WASHINGTON, 24 JANAR - Ligjvënësit amerikanë konfirmuan me një votim 74-25 që John Ratcliffe të jetë drejtor i Agjencisë Qendrore të Zbulimit, CIA. Ratcliffe, i cili shërbeu drejtor i Zbulimit Kombëtar gjatë mandatit të parë të presidentit

Trump, ka bërë betimin përpara nënpresidentit JD Vance.

Nënpresidenti Vance e cilësoi Ratcliffen "patriot të madh" dhe tha se ka besimin e presidentit.

Votimi erdhi tri ditë pasi Trumpi bëri betimin president

i 47 i Shteteve të Bashkuara dhe tri ditë pas një kërkese nga republikanët dhe demokratët më të lartë në Komitetin e Inteligjencës së Senatit për një votim të shpejtë mbi emërimin e Ratcliffes për ta udhëhequr CIA-n. "Bota jonë është shumë e rrezikshme që të ketë vonesa

nga Senati për konfirmimin e drejtorit të CIA-s", thanë senatorët Tom Cotton dhe Mark Warner në një deklaratë të hënën.

Ratcliffe është drejtori i parë i Agjencisë Qendrore të Zbulimit që ka drejtuar më parë Zbulimin Kombëtar.



# Trumpi thotë se do të takohet menjëherë me Putinin për t'i dhënë fund luftës në Ukrainë

WASHINGTON, 24 JANAR - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se dëshiron të takohet menjëherë me presidentin e Rusisë, Vladimir Putin, për ta arritur një marrëveshje e cila i jep fund pushtimit të plotë të Ukrainës nga Rusia. "Nga ajo çfarë kam dëgjuar, Putini dëshiron të më takojë, dhe do ta bëjmë sa më shpejt që është e mundur. Unë do ta takoj menjëherë", tha Trumpi për gazetarë në Shtëpinë e Bardhë të enjten.

Trumpi theksoi se presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, i ka thënë atij se është i gatshëm për ta bërë një marrëveshje për përfundimin e luftës.

Ndërkohë, duke folur përmes videolidhjes në Forumin Ekonomik Botëror në Davos të Zvicrës, Trumpi tha të enjten se dëshiron ta takojë Putinin së shpejti, duke shtuar se përpjekjet e ShBA-së për ta siguruar një marrëveshje për paqe kanë filluar, por nuk dha hollësi.

Gjatë fushatës presidenciale të vitit të kaluar, Trumpi thoshte vazhdimisht se do t'i jepte fund shpejt luftës dhe këtë e përsëriti edhe pak ditë para se ta merrte detyrën. Tani ai thotë se mund të nevojiten muaj për këtë.

Edhe Zelensky foli në Forumin Ekonomik Botëror, ku tha se nevojitet një forcë paqeruajtëse me 200 000 trupa për ta



garantuar çfarëdo marrëveshje armëpushimi me Rusinë në të ardhmen. Ai shtoi se një forcë e tillë paqeruajtëse do të ishte vetëm një nga pjesët e garancive të përgjithshme të sigurisë që do t'i nevojiteshin Kievit në rast se fillojnë bisedimet për armëpushim me Putinin.

Më herët Zelensky tha për "Bloomberg News" se për të qenë efektive një forcë paqeruajtëse, pjesë e saj duhet të jenë patjetër edhe trupat amerikane.

"Nuk mund të jetë pa Shtetet e Bashkuara", tha ai për "Bloomberg". "Së pari, askush nuk do të rrezikojë pa Shtetet e Bashkuara. Së dyti, kjo mund ta ndajë NATO-n, t'i ndajë Shtetet e Bashkuara dhe Bashkimin Evropian. Është ëndërr e Putinit ta ndajë këtë aleancë",

shtoi ai. Një forcë paqeruajtëse prej 200.000 trupash do të ishte përpjekje e paparë për Evropën, shumë më e madhe se forcat individuale të shumicës së kombeve. Misioni ndërkombëtar i udhëhequr nga NATO-ja në Bosnjë-Hercegovinë arriti kulmin në vitin 1996 me 60 000 trupa, rreth një e treta e tyre nga Shtetet e Bashkuara.

Zelensky tha se një forcë kaq e madhe ndërkombëtare do të ishte e nevojshme duke pasur parasysh se personeli i Ushtrisë së Rusisë tejkalon shifrën prej 1.5 milionësh, ndërsa Ukraina ka vetëm gjysmën e këtij numri. Vendosija e një force të huaj ushtarake në Ukrainë po diskutohet me vende që mund të jenë të gatshme të marrin pjesë, tha Zelensky në një

konferencë për shtyp me kryeministrin britanik Keir Starmer, më 16 janar.

Shtypi britanik raportoi se Starmer dhe presidenti francez Emmanuel Macron kanë biseduar për mundësinë e dërgimit të ushtarëve në Ukrainë si një forcë paqeruajtëse pas arritjes së ndonjë marrëveshjeje për t'i dhënë fund luftës.

Sekretari i ri amerikan i Shtetit, Marco Rubio, bisedoi me telefon më 23 janar me sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, dhe diskutoi për rëndësinë e përfundimit të luftës në Ukrainë.

Departamenti i Shtetit tha se Rubio riafirmoi angazhimin e ShBA-së ndaj NATO-s pasi Trumpi tha se "nuk është i sigurt" nëse Shtetet e Bashkuara duhet të shpenzojnë ndonjë gjë për aleancën, ndërsa i shtyu vendet e tjera anëtare t'i rrisnin shpenzimet për mbrojtjen deri në 5 për qind të PBB-së.

Zelensky tha se ekipi i tij është "aktualisht në proces" të organizimit të një takimi ballë për ballë me Trumpin, i cili e nisi mandatin e dytë më 20 janar.

Në ditët e fundit Trumpi ka bërë komentet më të ashpra deri më sot ndaj Putinit, për të cilin shpesh ka folur me admirim.

Më 22 janar Trumpi, duke iu drejtuar homologut të tij rus me

emër, paralajmëroi Moskën se do të përballet me tarifa, taksa dhe sanksione të reja "të larta" nëse nuk e ndal shpejt pushtimin e plotë të Ukrainës. Një ditë më herët ai sugjeroi se do të vendoste sanksione shtesë ndaj Rusisë nëse Putini nuk do të pranonte bisedimet për paqe për t'i dhënë fund luftës.

Dhe më 20 janar, në ditën e parë pas marrjes së mandatit të ri, Trumpi tha se Putini po e "shkatërron" Rusinë duke mos pranuar të bëjë një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës. "Ai duhet ta bëjë një marrëveshje. Mendoj se po shkatërron Rusinë duke mos e bërë një marrëveshje", tha Trumpi.

Rusia i ka derdhur qindra miliarda dollarë për luftën, ka pësuar rreth 700 000 viktima dhe ka zemëruar fqinjët e saj, gjithashtu ka sakrifikuar tregun fitimprurës evropian të gazit dhe qasjen në tregjet financiare perëndimore, gjë që ka çuar në rënien e vlerës së rublës.

Kremlini po shpenzon rreth 40 për qind të buxhetit për ushtrinë dhe po has në vështirësi të mëdha për ta frenuar inflacionin pavarësisht prej normave të interesit mbi 20 për qind.

Lufta në Ukrainë filloi në vitin 2014 me pushtimin dhe aneksimin e paligjshëm të Gadishullit të Krimesë nga Kremlini dhe u përshkallëzua me pushtimin e plotë të saj nga Rusia në shkurt 2022.

## Stuhia "Eowyn" godet Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandën

LONDËR, 24 JANAR - Mbretëria e Bashkuar dhe Irlanda po përballet me një mot të keq, teksa stuhia "Eowyn" ka trokitur në qytete.

Stuhia "Eowyn" tashmë ka thyer rekorde në Republikën e Irlandës, pasi era ka arritur shpejtësinë 183 km/h. Paralajmërimet janë bërë edhe për Skocinë, vend që pritet të përballet me mot të keq.

Njerëzit në të gjithë Mbretërinë e Bashkuar janë

këshilluar të mos udhëtojnë, pasi ekzistojnë paralajmërimet të shumta të motit.

Rrjetet Elektrike Skoceze dhe Jugore raportuan se kanë rikthyer energjinë për 6 568 konsumatorë që kishin humbur furnizimet që nga fillimi i stuhisë herët në mëngjes. Sipas tyre, 2 621 klientë janë aktualisht jashtë furnizimit dhe pret ndërprerje të mëtejshme gjatë ditës së sotme.



Stuhia "Eowyn" ka detyruar vendit të mbyllin dyert e tyre qindra shkolla anembanë sot. Më e prekura është

Irlanda e Veriut, ku të gjitha shkollat janë mbyllur.

Glasgow dhe Edinburgu kanë mbyllur të gjitha shkollat e tyre. Ndërkohë, ka rreth 30 shkolla të mbyllura në të gjithë Northumberland, shtatë në Cumberland dhe pak më shumë se 30 në të gjithë Uellsin veriperëndimor.

Transporti hekurudhor është ndaluar në shumë qytete, për t'i shmangur incidentet pasi shpejtësia e erës vijon të mbetet e lartë.



## 25 vjet nga themelimi i gazetës "Epoka e re"

Prishtinë, 24 janar - Gazeta e përditshme "Epoka e re" është themeluar më 15 dhjetor 1999, por numri i saj i parë ka dalë më 25 janar 2000.

Sot (e shtunë) "Epoka e re" ka mbushur 25 vjet që nga numri i parë.

Pas fillimit të pandemisë Covid-19 u ndal botimi i

medieve të shtypura.

Sot Kosova vazhdon të jetë vendi i vetëm në botë pa gazetë të shtypur ditore.

"Epoka e re" botohet online <https://www.epokaere.com> dhe në formatin PDF.

Në formatin PDF sot është botuar numri i 7 977 i "Epokës së re".

Botues i gazetës "Epoka e re"

është Muhamet Mavraj, personalitet i njohur i demonstratave studentore të vitit 1997.

"Epoka e re" shquhet për kuadrin e saj kritik gazetaresk, i cili synon arritjen e një informacioni të ri në mjedisin shqiptar dhe formimin e audiencës kritike.



# Partitë politike po shfrytëzojnë resurset shtetërore për fushatë

PRISHTINË, 24 JANAR - Partitë politike po shfrytëzojnë resurset shtetërore për të bërë fushatë. Me dhjetëra raste janë shënuar vetëm në javën e parë të fushatës zgjedhore. Organizatat që po monitorojnë këtë proces thonë se po shfrytëzohen veturat zyrtare, hapësirat e institucioneve publike, por edhe raste kur shërbyesit civilë janë në tubime publike, ani pse në orar të punës.

Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme e ndalon shfrytëzimin e resurseve shtetërore gjatë periudhës së fushatës zgjedhore. "Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik", thuhet në nenin 36 të këtij ligji.

Hulumtuesja e lartë në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI), Violeta Haxholli, thotë se ka pasur raste të gjobitjes së partive politike për shfrytëzim të resurseve shtetërore. "Në disa organizime të partisë në pushtet ka pasur prani të veturave zyrtare dhe të shërbyesve publikë, por edhe në rastet apo aktivitetet që janë organizuar nga partitë opozitare si PDK, LDK, AAK, sidomos në komunat që qeverisen nga këto parti. Disa

raste janë raportuar edhe në PZAP [Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësja], ku janë shqiptuar disa gjoba. Prandaj, partitë politike janë të njoftuara që këto janë praktika të ndaluara, megjithatë ne po e hasim gjatë vëzhgimit të fushatës. Janë diku pesë raste të cilat janë [gjobitur] për shfrytëzimin e resurseve publike. Po shohim që gjobat janë të shqiptuara nga PZAP në përgjithësi për të gjitha partitë. Deri më tani shuma totale e shqiptuar nga PZAP kalon 100 mijë euro. Po këtu hyn shkëlja e rregullave të tjera", thotë ajo.

Vetëm në javën e parë të fushatës zgjedhore, siç tregon Haxholli, janë rreth 20 raste të shfrytëzimit të resurseve shtetërore. "Kemi hasur 18 raste që partitë politike kanë shfrytëzuar resurset shtetërore. Këtu përfshihen përdorimi i veturave zyrtare dhe i shërbyesve publikë gjatë orarit të punës. Siç dihet, legjislacioni parashihet që veturat zyrtare sipas protokollit shtetëror mund t'i përdorin vetëm kryeministri i vendit, kryetari i Kuvendit dhe ministri i Jashtëm. Ndërsa në rastet kur shteti mund të vlerësojë që mund të ketë ndonjë rrezik për ministrat, atëherë hyn edhe në funksion protokollit i sigurisë dhe në këtë rast mund që edhe ministri i Punëve të Brendshme t'i shfrytëzojë veturat zyrtare. Ndërsa te rasti i shërbyesve



publikë ata kanë të drejtë të marrin pjesë në aktivitete të partive politike vetëm pas orarit të punës, jo gjatë orarit të punës", shprehet Haxholli.

Ani pse në orar të punës, ka raste kur shërbyes civilë marrin pjesë në tubime të partive politike, thotë Viona Bunjaku nga "Lëvizja Fol". "Ne kemi identifikuar që pesë prej tyre [raste] janë vetura zyrtare që janë përdorur nga partitë politike për të shkuar në fushatë. Pastaj kemi edhe nëpunës publikë të cilët gjatë orarit të tyre të punës kanë shkuar në tubime zgjedhore.

Duke filluar nga mjekë, punëtorë, shërbyes civilë në administratë publike, të cilët janë të ndaluar me Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Shfrytëzimi i resurseve publike ka ndodhur jo vetëm këtë vit. Na përcjell vazhdimisht në zgjedhje. Veturat dhe të gjitha këto mjete të cilat janë të ndaluara me ligj, përdoren në fushata zgjedhore", thotë Bunjaku për kp.

Shfrytëzimi i resurseve shtetërore, sipas Violeta Haxhollit nga KDI, në disa raste po bëhet qëllimisht. "Disa bëhen qëllimshëm, disa shkelje

të rregullave bëhen edhe nga pakujdesia. Ne mendojmë se qëllimshëm bëhet përdorimi i gjuhës nxitëse, përdorimi i gjuhës së urrejtjes për të cilat subjektet politike e dinë që është e ndaluar, por që po vazhdojnë ofendimet, fyerjet e liderëve ndaj njëri-tjetrit. Pastaj disa bëhen nga pakujdesia", përfundon Haxholli.

Qysh në ditët e para të fushatës PZAP-ja ka dënuar disa subjekte politike për shkak të gjuhës së përdorur në tubime. Fushata ka nisur më 11 janar, ndërkaq zgjedhjet do të mbahen më 9 shkurt.

## Kosovës i shtohen 462 policë të rinj

PRISHTINË, 24 JANAR - Me intonimin e himnit shtetëror, të premtën kanë diplomuar 462 kadetë të Policisë së Kosovës të gjeneratës së 61-të. Prej tyre, 79 kadetë të diplomuar janë nga komuniteti serb në Kosovë.

Pjesëmarrës në këtë ceremoni ishin personalitete të larta shtetërore dhe ndërkombëtare, familjarë të zyrtarëve policorë dhe eprorë të Policisë së Kosovës. Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka thënë se me diplomimin e gjeneratës së 61-të po fuqizohet edhe më shumë Policia e Kosovës. Ajo ka theksuar se atdheut tonë



po i bashkohen edhe 462 gardianë apo 462 djem e vajza në mbrojtje të vendit tonë. "Janë 56 vajza e gra në këtë grup, por na duhen edhe më shumë. Policia jonë është me ne në çdo ditë, në çdo festë, edhe kur ne pushojmë. Sakrificat dhe përkushtimi i tyre është i



pashoq. Ata çdo ditë mbrojnë sovranitetin dhe territorin e Republikës së Kosovës. I përkulemi heroizmit të heroit të Kosovës, Afrim Bunjakut, i përkulemi edhe heroizmit të Enver Zymberit dhe atyre që ranë në detyrë në mbrojtje të atdheut", ka thënë Osmani.

Ndërsa kryeministri Albin Kurti ka thënë se ka shumë mënyra për t'i shërbyer vendit, por nuk ka rrugë më të drejtpërdrejtë se ta veshësh uniformën policore dhe t'u përgjigjesh thirrjes së qytetarëve. Ai ka thënë se zotimi i tyre ishte për 2 000 policë të rinj. Sipas Kurtit, për katër vjet diplomuan 6 gjenerata, që deri më sot i bie gjithsej 2 475 pjesëtarë të rinj policorë.

"Struktura gjinore dhe etnike e kësaj gjenerate kadetësh që nga sot po bëhen policë, e tregon edhe vetë strukturën e shoqërisë sonë dhe politikën e shtetit të Kosovës.

Në gjeneratën e 61-të sot po diplomojnë gjithsej 462 pjesëtarë të rinj të policisë, prej të cilëve 406 djem dhe burra dhe 56 vajza dhe gra. Nga kjo gjeneratë, 343 pjesëtarë janë shqiptarë, 79 serbë, 23 boshnjakë, 6 turq, 6 egjiptianë, 3 ashkali dhe 2 pjesëtarë janë romë. Kjo larushi etnike, përveçse e reflekton barazinë në qasje dhe mundësi ndaj secilit në shoqërinë tonë, e shpërfaq edhe suksesin e integritetit të komuniteteve joshumicë në institucionet e Kosovës, deri këtu në institucionet e sigurisë", ka thënë kryeministri Kurti.





## Ambasadorët e BE-së konfirmojnë Sorensenin emisar për dialogun Kosovë - Serbi

Ambasadorët e Bashkimit Evropian të premtën e kanë konfirmuar Peter Sorensenin për pozitën e të deleguarit të Bashkimit Evropian për dialogun Kosovë - Serbi. Sorensen nga 1 shkurti pritet ta zëvendësojë në këtë pozitë Miroslav Lajçakun, mandati i të cilit kalon më 31 janar. Diplomati danez në këtë pozitë është zgjedhur nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 24 JANAR** - Diplomati nga Danimarka, Peter Sorensen, është konfirmuar nga ambasadorët e Bashkimit Evropian për pozitën e përfaqësuesit të posaçëm të bllokut për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Sorensen është zgjedhur nga përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri, Kaja Kallas, për ta

zëvendësuar Miroslav Lajçakun në këtë pozitë.

Ministrat e Jashtëm të BE-së do ta japin pëlqimin përfundimtar të hënën, në mënyrë që Sorenseni ta nisë mandatin e tij nga fillimi i shkurtit. Të dërguarit aktual, Lajçak, i skadon mandati më 31 janar. Sorenseni ka përvojë të gjatë diplomatike në strukturat e BE-së. Ai aktualisht është këshilltar i lartë në Shërbimin e Veprimit të jashtëm të BE-së (EEAS) për diplomaci digjitale.

Gjatë karrierës së tij diplomatike në BE, Sorenseni ka ushtruar disa detyra në Ballkanin Perëndimor. Ka shërbyer përfaqësues i posaçëm i BE-së për Bosnjë-Hercegovinë dhe shef i Zyrës së BE-së në Sarajevë. Po ashtu, ka qenë edhe shef i delegacionit të bllokut evropian në Shkup.

Më herët Sorenseni ka punuar këshilltar në misionin e Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa ka qenë edhe përfaqësues i

posaçëm i përfaqësuesit të lartë të BE-së në Serbi.

Në Ballkan ai ka punuar edhe në misionin e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE) në Kroaci.

Përvoja e tij nga rajoni thuhet se ka qenë edhe një prej argumenteve se pse Kaja Kallas ka vendosur që ai të jetë pasardhësi i Lajçakut.

Për pozitën e lehtësuesit të dialogut garoi edhe emri i ish-ministrit të Jashtëm të Finlandës, Pekka Haavisto, i cili ka njohuri për zhvillimet në Ballkanin Perëndimor.

Për këto rol ishte përmendur edhe emri i ish-presidentit dhe ish-kryeministrit të Sllovenisë, Borut Pahor. Vitin e kaluar ai pranoi se ishte i interesuar për këtë post. Por, gjatë janarit të këtij viti tha se nuk do të garonte

për këtë post, pasi ka kuptuar se kërkohet më shumë një nivel diplomatik sesa politik.

Gjatë mandatit gati pesëvjeçar të Lajçakut, Kosova dhe Serbia kanë arritur Marrëveshjen në rrugën drejt normalizimit të raporteve.

Marrëveshja, e cila nuk është nënshkruar, është ligjrisht e obligueshme për palët, ka thënë blloku. BE-ja i ka akuzuar Kosovën dhe Serbinë për mosnisen e zbatimit të paktit, duke thënë se kjo do të ndikojë në rrugëtimin e dy shteteve drejt integriteteve evropiane.

Dialogu për normalizimin e raporteve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, që ndërmjetësohet nga Bashkimi Evropian, ka nisur më 2011. Gjatë procesit janë arritur disa marrëveshje, por pak prej tyre janë zbatuar në terren.

## Aktakuzë ndaj një personi për krime lufte në Kosovë

**PRISHTINË, 24 JANAR** - Prokuroria Speciale e Kosovës njoftoi se ka ngritur aktakuzë ndaj një personi për krime lufte kundër popullatës civile në Kosovë.

J. Sh., i nacionalitetit boshnjak, i cili aktualisht gjendet në paraburgim, akuzohet nga Prokuroria se gjatë luftës në Kosovë ka marrë pjesë në "vrasjen e tre

civile të nacionalitet shqiptar, e të cilat kanë ndodhur në shtëpinë e familjes Dyla në Gjakovë". "Gjithashtu, hetimet kanë zbuluar se i pandehuri ka marrë pjesë në dëbimin e familjes Dyla dhe shkatërrimin e pasurisë së saj", thuhet në njoftimin e Prokurorisë Speciale.

Ky institucion nuk ofroi hollësi se në cilën periudhë kohore

saktësisht dyshohet se J. Sh. ka kryer këto vepra penale.

Së fundi, Prokuroria Speciale ka ngritur disa akuzë për krime që kanë ndodhur gjatë luftës më 1998/99.

Ndërkaq, që nga përfundimi i luftës së fundit në Kosovë, rreth 70 persona janë dënuar për krime lufte para institucioneve vendore dhe ndërkombëtare.

Nga viti 2000 deri në vitin 2008 krimet e luftës në Kosovë janë hetuar nga Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), ndërsa nga viti 2008 nga Misioni i Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX).

Në vitin 2018 ky mision i ka dorëzuar lëndët në Prokurorinë e Kosovës dhe në gjykatat vendore.



Gjatë luftës së fundit në Kosovë më 1998-1999 janë vrarë mbi 13 000 civilë dhe mijëra të tjerë janë zhdukur. Mbi 1 600 persona vazhdojnë të jenë ende të pagjetur, pjesa më e madhe e tyre shqiptarë.



# Pezullimi i ndihmave amerikane do të jehojë në gjithë botën, edhe në Kosovë



## USAID-i thotë se ka investuar më shumë se 1 miliard dollarë në zhvillimin e Kosovës që nga viti 1999

PRISHTINË, 24 JANAR - Grupet humanitare, organizatat joqeveritare, sipërmarrësit, fermerët dhe qeveritë në të gjithë botën po përcjellin me shqetësim planet e Uashingtonit, pasi presidenti i sapobetuar amerikan, Donald Trump, e pezulloi ndihmën për vendet e huaja, në pritje të një vlerësimi nga administrata e tij. Në Kosovë një përpunues i drurëve shpreson se Uashingtoni nuk do t'ia kthejë shpinën vendit të tij. Në Afganistan, ngrirja e ndihmave amerikane do të ishte "katastrofike" për miliona qytetarë në nevojë të këtij vendi, thotë udhëheqësi i një grupi të madh ndërkombëtar të ndihmës. Në Ukrainë, një aktiviste kundër korrupsionit, thotë se ndërprerja e financave nga ShBA-ja mund ta sinjalizojë pakësimin e mbështetjes nga ky vend për reformat demokratike. Trumpi nënshkroi urdhrin ekzekutiv për pezullimin e ndihmave amerikane për zhvillim për 90 ditë, duke thënë se "asnjë ndihmë e mëtejshme e Shteteve të Bashkuara, nuk do të jepet në atë mënyrë që nuk përkon plotësisht" me politikën e tij të jashtme. Urdhri i Trumpit nuk specifikoi se cilat vende, programe ose

pranues të këtyre ndihmave do të preken dhe nuk ishte menjëherë e qartë se si do të ndikojë ai në ndihmat tashmë të përvetësuara nga Kongresi amerikan në buxhetin federal.

### Ndikimi në Kosovë

Kreshnik Shehu, një përpunues i drurëve në Kosovë, thotë se ndihma e ShBA-së ka luajtur rol të rëndësishëm në rritjen e eksporteve të kësaj lënde. Kompania e Shehut, ashtu si edhe sektori i drurit në përgjithësi në Kosovë, kanë përfitur nga financimet e USAID-it (Agjencisë së ShBA-së për Zhvillim Ndërkombëtar). "Në vitin 2014 eksportet në sektorin tonë ishin 2.5 milionë euro", thotë Shehu për Radion Evropa e Lirë. "Sot ato janë më shumë se 150 milionë euro. Kjo tregon se gjatë dhjetë vjetëve të fundit, kontributi i USAID-it ka qenë shumë i madh. Ai ka qenë një faktor vendimtar në rritjen e këtij sektori", shton Shehu. USAID-i thotë se ka investuar më shumë se 1 miliard dollarë në zhvillimin e Kosovës që nga viti 1999. "Nëse ajo ndihmë nuk do të ekzistonte, do të kishim mbetur shumë vjet prapa", thotë Shehu, kompania e të cilit e ka selinë në qytetin e Drenasit. Shehu thotë se "nuk dua të

besoj se USAID-i do të na kthejë shpinën". "Ne ende kemi nevojë për të, sepse ende nuk jemi rritur sa duhet për ta përballuar konkurrencën e pabesueshme në tregun ndërkombëtar", thotë ai.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, konfirmon se USAID-i ka luajtur rol të rëndësishëm në zhvillimin e shtetit të Kosovës. "USAID-i vazhdon të ndihmojë shoqata dhe biznese të shumta, përfshirë ndërmarrje të udhëhequra nga gratë, kompani të teknologjisë informative dhe biznese të orientuara nga eksporti", thotë Rafuna.

Ai shton se USAID-i ka ndihmuar edhe në uljen e tensioneve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. "Ka qenë i rëndësishëm në ofrimin e ndihmës për gjetjen e zgjidhjeve për mosmarrëveshjet tregtare, që përfshinin eksportet dhe importet në tregjet serbe dhe rajonale. Pra, përveç nxitjes së zhvillimit ekonomik, USAID-i ka luajtur rol jetik në uljen e tensioneve mes dy vendeve", sipas Rafunës.

Trumpi, prej kohësh, ka qenë kritik ndaj ndihmave të ShBA-së për vendet e huaja, të cilat përbëjnë rreth 1 për qind të buxhetit federal. "Ne do të japim ndihma vetëm për ata që na respektojnë dhe, sinqerisht, janë miqtë tanë", ka thënë Trumpi gjatë mandatit të parë presidencial, derisa ka mbajtur një fjalim në Kombet e Bashkuara në vitin 2018.

Në një deklaratë të lëshuar më 22 janar, sekretari i ri i Shtetit, Marco Rubio, i zgjedhur nga Trumpi, ka thënë: "Çdo dollar që shpenzojmë, çdo program që financojmë dhe çdo politikë që ndjekim, duhet të justifikohet me përgjigje në tri

pyetje të thjeshta: A e bën Amerikën më të sigurt? A e bën Amerikën më të fortë? A e bën Amerikën më të begatë?".

### Ndikimi në Afganistan

Sekretari i përgjithshëm i Këshillit Norvegjez të Refugjatëve, Jan Egeland, shpreson të mos ketë ngrirje të ndihmave humanitare për Afganistanin. "Nëse ka, do të ishte katastrofike për më shumë se 22 milionë afganë që kanë nevojë për ndihmë", thotë Egeland për Radion Evropa e Lirë.

Prej se talibanët kanë marrë pushtetin në Afganistan në vitin 2021, Uashingtoni ka ofruar gati tre miliardë dollarë ndihmë për Afganistanin, sipas Inspektorit të Përgjithshëm Special për Rindërtimin e Afganistanit.

Kërkesa për buxhetin e vitit 2025 nga administrata e paraardhësit të Trumpit, Joe Biden, përfshinte edhe rreth 104 milionë dollarë për shëndetësinë, arsimin dhe forma të tjera të ndihmës për Afganistanin. Një vit më parë kjo shumë ishte 143 milionë dollarë.

Urdhri ekzekutiv i Trumpit i jep Rubios fuqi për ta shtyrë pauzën tremujore për "programe specifike".

Egeland shpreson se do të ketë përfundim për ndihmat humanitare për Afganistanin, nga i cili ShBA-ja tërheqi forcat e saj në gusht të vitit 2021 - pas një pranije 20-vjeçare. "Ndihma për zhvillim nuk shkon për regjimin, nuk shkon për udhëheqjen. Ajo u shkon njerëzve shumë të varfër që kanë nevojë për ndihmë", thotë Egeland.

Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar refuzoi të komentojë, kurse

Shtëpia e Bardhë nuk u përgjigj.

### Ndikimi në Ukrainë

Prej se Rusia ka nisur pushtimin në shkallë të plotë të Ukrainës në shkurt të vitit 2022, USAID-i i ka ofruar Ukrainës miliarda dollarë në ndihma humanitare, ndihma zhvillimore dhe mbështetje të drejtpërdrejtë buxhetore.

Trumpi e ka kritikuar shumën e këtyre ndihmave - përfshirë edhe miliarda dollarët në armë - që administrata Biden ia ka dhënë Ukrainës.

Svitlana Musiak, studiuese në Komisionin e Pavarur Kundër Korrupsionit (NAKO), me qendër në Kiev, thotë për Radion Evropa e Lirë se pezullimi i fondeve të USAID-it për Ukrainën mund të ndikojë negativisht në programet e shoqërisë civile dhe "ta sinjalizojë reduktimin e mbështetjes së ShBA-së për reforma demokratike dhe stabilitet ekonomik në vend".

"Situatat e tilla mund ta komplikojnë zbatimin e ndryshimeve, por nuk do t'i ndalojnë ato [organizatat e shoqërisë civile]", thotë Musiak.

Andriy Kravchuk, përfaqësues i grupit për të drejtat e komunitetit LGBT "Bota jonë", e cilëson ndihmën e ShBA-së për shoqërinë ukrainase "shumë domethënëse, por jo vendimtare". "Ne shpresojmë se Departamenti i Shtetit [në ShBA] do të vazhdojë t'i mbështesë aktivitetet tona, pasi ai, në fund të fundit, i përdor të dhënat tona për raportet e tij vjetore për Ukrainën", thotë Kravchuk. "Ne kemi marrë fonde prej tyre edhe gjatë mandatit të parë të presidentit Trump", përfundon ai.



# Çfarë përfiton Kosova nga marrëveshja për tregti të lirë me EFTA-n?

PRISHTINË, 24 JANAR - Kosova nënshkroi më 22 janar një marrëveshje me Shoqatën Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), pas bisedimeve që zgjatën më shumë se dy vjet e gjysmë. Kush është pjesë e shoqatës, si do të përfitojnë prodhuesit kosovarë nga marrëveshja e tregtisë së lirë dhe cilat janë lehtësitë për ta? Ekrem Idrizi na i sjell hollësitë. Nëse një prodhues vendës kosovar është detyruar të paguajë një tarifë shtesë doganore prej 10-përqindësh për t'i eksportuar mallrat e veta në një vend me mërgatë të madhe, si Zvicra, nga tani ai, lëre më që nuk do të paguajë çmim shtesë, por nuk do të paguajë fare tarifë doganore. Këtë e ka mundur një marrëveshje e saponëshkruar ndërmjet Kosovës dhe Shoqatës Evropiane të Tregtisë së Lirë (EFTA), ku, përveç Zvicrës, bëjnë pjesë edhe Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia.

Heqja e tarifave është një nga lehtësitë që do t'i gëzojnë kompanitë kosovare që eksportojnë apo duan të eksportojnë në vendet anëtare të EFTA-s, me të cilën Kosova e nënshkroi më 22 janar një Marrëveshje për Tregti të Lirë, më pak se tri vjet pasi i hapi bisedimet me këtë organizatë. Marrëveshja ofron shumë mundësi, përfshirë ato për importimin dhe eksportimin e mallrave. Konsumatorët dhe kompanitë mund të gëzojnë çmime më të lira, ndërsa kompanitë vendëse mund t'i shesin produktet e tyre më me lehtësi në tregjet e huaja. Marrëveshja u mundëson kompanive në vendet kontraktuese qasje të

ngjashme ose më të mirë sesa konkurrentët e tyre nga vendet e treta, sipas EFTA-s.

Kryetari i Odës Ekonomike të Kosovës, Lulzim Rafuna, thotë për Radion Evropa e Lirë se kjo marrëveshje nënkupton shumë për Kosovën. "Marrëveshje të tilla, për një treg të vogël, siç është Kosova, duhet të kenë qëllim strategjik sa më shumë, sepse kjo u ndihmon investimeve të huaja, sepse çdo investitor që vjen në Kosovë i prodhon dhe eksporton mallrat në këto vende të EFTA-s", pohon Rafuna.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, u shpreh i bindur pas nënshkrimit të marrëveshjes në Davos të Zvicrës se ajo "do të sjellë përfitime për bizneset, industrinë dhe qytetarët e të gjitha vendeve [palë]".

## Kush përfiton më së shumti nga kjo marrëveshje?

Marrëveshja në mes të Kosovës dhe EFTA-s mbulon fusha si tregtia e mallrave dhe shërbimeve, të drejtat e pronësisë intelektuale, lehtësimin tregtar, zhvillimin e qëndrueshëm tregtar, dhe provizionet ligjore e horizontale. Sipas Rafunës, prodhuesit vendës do të përfitojnë më së shumti nga kjo marrëveshje, për arsye se do ta kenë mundësinë që të gjitha produktet me origjinë të Kosovës t'i eksportojnë në këto vende, pas pasur nevojë të paguajnë tarifë doganore. E njëjta do të vlejë edhe për mallrat që hyjnë në Kosovë nga këto vende. "Ne kemi diasporë shumë të madhe në Zvicër,



dhe falë kësaj marrëveshjeje ata do të përfitojnë, për t'i tërhequr produktet e Kosovës në tregun zviceran, por edhe produktet e tyre, apo partnerëve të tyre, në tregun kosovar, pa tarifë doganore", thotë Rafuna.

Kompania "S//Sprint", me bazë në Podujevë, e cila merret me prodhimin e veshjeve sportive, ka vite që eksporton prodhimet e veta në anëtarin e EFTA-s, Zvicrën, si dhe në vende të tjera rajonale dhe evropiane.

Pronari i saj, Sami Sopa, thotë për Radion Evropa e Lirë se kompania është përballur në të kaluarën me vështirësi për të eksportuar në tregun zviceran, duke u detyruar të paguajë tarifë shtesë doganore. "Kur është futur malli i Kosovës në Zvicër, ata kanë menduar që është evropian, më vonë kanë konstatuar që është nga Kosova, dhe kanë kërkuar pagesë shtesë deri në 10 për qind", tregon Sopa.

Ai shpreson se marrëveshja do t'ia lehtësojë eksportin në tregun zviceran, të cilin e

cilësoi si "shumë të volitshëm dhe të rëndësishëm për ne, sepse kemi shumë mërgimtarë atje, të cilët i blejnë produktet tona".

Rreth 115 000 kosovarë jetojnë në Zvicër, sipas të dhënave të fundit nga viti 2022 të Sekretariatit Shtetëror të Zvicrës për Imigrim. Agjencia e Statistikave e Kosovës ende s'i ka publikuar të dhënat e regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 për kosovarët që jetojnë në Zvicër.

Sopa thotë se kompania e tij do të synojë ta shfrytëzojë edhe mundësinë që marrëveshja e re ndërmjet Kosovës dhe EFTA-s ua ofron kompanive kosovare për të eksportuar mallra edhe në tregjet e vendeve të tjera.

## Cili është bilanci tregtar në mes të Kosovës dhe EFTA-s?

Tregtia dypalëshe në mes të Kosovës dhe EFTA-s nisi qysh në vitin 2008, pas pavarësisë së vendit. Prej atëherë, ka shënuar rritje të vazhdueshme, ndërsa më 2023 e arriti shifrën

më të lartë: 176 milionë euro, sipas të dhënave në ueb-faqen e kësaj organizate.

Gjatë vitit 2023, Kosova eksportoi në vendet e EFTA-s mallra në vlerë prej 76 milionë eurosh, ndërsa importoi produkte nga to në vlerë prej 99 milionë eurosh.

Shkalla mesatare e importit shënoi rritje prej 20.4 për qind në pesë vjetët e fundit, ndërsa ajo e eksportit 26.6 për qind gjatë asaj periudhe.

Tregtia ndërmjet Kosovës dhe Zvicrës gjatë vitit 2023 arriti vlerën e 141 milionë eurove. Kosova eksportoi mallra në vlerë prej 75 milionë eurosh në Zvicër, ndërsa importoi në vlerë prej 66 milionë eurosh nga ajo. Në të dhënat për tregtinë me Zvicrën futet edhe Lihtenshtajni, pasi këto dy vende kanë doganë të përbashkët, sipas EFTA-s.

Kosova eksporton në vendet e EFTA-s kryesisht mallra si orëdi, plastika, hekur dhe çelik, si dhe produkte të drurit, ndërsa importon nga to kryesisht vetura, produkte farmaceutike, duhan dhe makineri.

## Premtimi i madh i Bedri Hamzës: Kosovën dhe Shqipërinë do t'i lidhim edhe me hekurudhën e kombit



PRISHTINË, 24 JANAR - Kandidati i PDK-së për kryeministër, Bedri Hamza, ka treguar projektet e tij për hekurudhën e Kosovës. Hamza ka thënë se do ta ndërtojë edhe hekurudhën e kombit për forcimin e lidhjes mes shqiptarëve. Kjo linjë hekurudhore moderne, Hamza ka thënë se duhet të vazhdojë më pas edhe drejt Malit të Zi, që Kosova ta përforcojë daljen në det dhe lidhjen me shtetet e rajonit. "Kosovën do ta lidhim me hekurudhë, me Shqipërinë dhe shtetet e rajonit. Transporti hekurudhor ul

ndjeshëm shpenzimet e qytetarëve dhe ndikon pozitivisht në ekonominë e vendit. Redukton ndotjen dhe kontribuon në mbrojtjen e mjedisit. Ne do ta përfundojmë projektin e modernizimit të Linjës Hekurudhore 10, që lidh Hanin e Elezit me Leshakun. Dhe, pas rrugës së kombit, do ta ndërtojmë edhe hekurudhën e kombit. Kjo linjë hekurudhore moderne që forcon lidhjen mes shqiptarëve duhet të vazhdojë më pas edhe drejt Malit të Zi. Për sa i përket transportit të brendshëm hekurudhor, do ta

funksionalizojmë linjën Klinë - Prizren dhe do ta elektrifikojmë rrjetin hekurudhor në krejt Kosovën, duke e rritur shpejtësinë minimale të lëvizjes deri në 120 kilometra në orë", thotë Hamza në këtë video të postuar prej tij. Hamza ka premtuar edhe nga Prishtina deri në Aeroportin "Adem Jashari" do të ketë linjë hekurudhore funksionale. "Me hekurudha moderne, çdo qytetar do të udhëtojë më shpejt, më lirë, më pastër dhe më sigurt. Me hekurudha moderne, Kosovën do ta bëjmë ma të mirë!", thotë Hamza.



## Kosova dhe Holanda nënshkruajnë planin bilateral të mbrojtjes për vitin 2025

PRISHTINË, 24 JANAR - Në Ministrinë e Mbrojtjes është nënshkruar plani bilateral në fushën e mbrojtjes për vitin 2025 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Mbretërisë së Holandës. "Plani mes dy vendeve u nënshkrua nga nënkolonel Liridon Poroshtica, përfaqësues nga Departamenti

për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Euroatlantike dhe atashëu i Mbrojtjes për Kosovë nga Mbretëria Holandeze, nënkolonel Jurgen Fleischmann. Ky plan i ri për vitin 2025 synon zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse, shkëmbimin e përvojave dhe

fuqizimin e lidhjeve strategjike ndërmjet Kosovës dhe Holandës. Gjithashtu, ky bashkëpunim i fortë dëshmon përkushtimin e të dy vendeve për të punuar ngushtë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe për të kontribuar në paqen dhe stabilitetin global", ka njoftuar Ministria e Mbrojtjes.



## BE-ja rikonfirmon mbështetjen për arsimin në Kosovë

PRISHTINË, 24 JANAR - Bashkimi Evropian ka rikonfirmuar përkushtimin e vazhdueshëm për avancimin e sektorit të arsimit në Kosovë. Një gjë të tillë BE e ka bërë me dije përmes një komunikate të zyrës së saj në Kosovë, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Arsimit. "Që nga viti 2007 BE-ja ka investuar mbi 85 milionë euro në iniciativë që synojnë rritjen e cilësisë, aksesit dhe gjithëpërfshirjes së sistemit arsimor për të gjitha komunitetet në Kosovë. Këto përpjekje synojnë t'u ofrojnë studentëve dhe akademisë në Kosovë mundësi të krahasueshme me ato në BE, duke kontribuar në zhvillimin ekonomik të bazuar në njohuri dhe krijimin e vendeve të punës", thuhet në komunikatë.



Më tutje theksohet se mbështetja gjithëpërfshirëse e BE-së përfshin të gjitha nivelet e arsimit, nga arsimi i fëmijërisë së hershme deri te trajnimi

profesional (AFP) dhe arsimi i lartë. "Ky investim jo vetëm që ka përmirësuar infrastrukturën arsimore, por ka forcuar kornizën e politikave që qeveris

arsimin në Kosovë, ka përmirësuar cilësinë e materialeve mësimore dhe teksteve shkollore, ka promovuar mësimin digjital dhe ka mbështetur përfshirjen e grupeve të cenushme", thuhet tutje në komunikatë. Si pjesë e programit më të gjerë të BE-së për Punësim dhe Arsim, BE-ja ka mbështetur ndërtimin e objekteve të reja të fakultetit për Fakultetin e Shkencave Matematiko-Natyrore me vlerë 8.9 milionë euro. "Deri më sot BE ka financuar ndërtimin e shkollave të reja dhe rinovimin e mbi 20 objekteve arsimore, duke përmirësuar ndjeshëm mjediset e të mësuarit. Për më tepër, përmirësimet e efikasitetit të energjisë në më shumë se 60 shkolla anëmbanë

Kosovës kanë reduktuar konsumin e energjisë deri në 30%, duke nënvizuar përkushtimin e BE-së për qëndrueshmëri", theksohet tutje në komunikatën e Zyrës së BE-së në Kosovë. Një nga iniciativat kryesore në përmirësimin e sistemit arsimor të Kosovës është projekti Mbështetja e Arsimit Bazë dhe të Mesëm të Lartë (KosEd), i cili fokusohet në zhvillimin e mësimdhënësve, rekrutimin dhe cilësinë e teksteve shkollore. Me mbi 1 000 mësues të angazhuar, KosEd do të ndikojë drejtpërdrejt në 21 % të shkollave të Kosovës deri në qershor 2025, thuhet në komunikatë, e ku janë përmendur edhe projekte të tjera të mbështetura nga BE-ja.

## Haradinaj viziton Legjionin Amerikan, njoftohet për punën që amerikanët bëjnë për veteranët e luftës

PRISHTINË, 24 JANAR - Në kuadër të vizitës në ShBA, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, është ftuar për vizitë në Legjionin Amerikan, ku është prituri nga drejtori ekzekutiv Mario Marquez, drejtori Joseph C. Sharpe Jr., dhe Besa Pinchoti, shefe ekzekutive e familjeve ushtarake. "U njoftova lidhur me punën që bëjnë për veteranët,

rregulloret e punës, shtrirjen, si dhe kuadrin ligjor që rregullon funksionimin dhe financimin e kësaj organizate të rëndësishme për veteranët dhe familjet e tyre, si dhe për familjet e të rënëve në mbrojtje të demokracisë, vlerave dhe interesave kombëtare të Shteteve të Bashkuara", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



## Ushtarët amerikanë kryejnë patrullime në kufirin Kosovë - Serbi



PRISHTINË, 24 JANAR - Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, ka njoftuar se ushtarët amerikanë, të caktuar në Komandën Rajonale në Lindje të misionit, kanë kryer sot një patrullë rutinë në veri të Kosovës përgjatë vijës kufitare. KFOR-i ka thënë se këto përpjekje janë pjesë e misionit të përditshëm të KFOR-it për

të garantuar një mjedis të sigurt për të gjitha komunitetet që jetojnë në Kosovë. KFOR-i ka përsëritur se vazhdon ta zbatojë mandatin e tij, bazuar në Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së të vitit 1999, për të kontribuar në një mjedis të sigurt për të gjithë njerëzit dhe komunitetet

që jetojnë në Kosovë dhe lirinë e lëvizjes, "në çdo kohë dhe në mënyrë të paanshme". KFOR-i ka thënë se punon në koordinim të ngushtë me Policinë e Kosovës dhe Misionin e Bashkimit Evropian për Sundimin e Ligjit në Kosovë (EULEX) në rolet e tyre përkatëse si reagues të sigurisë.



## Guvernatori i BQK-së merr pjesë në takimin themelues të grupit drejtues për implementimin e SEPA-s

PRISHTINË, 24 JANAR - Guvernatori i BQK-së, Ahmet Ismaili, së bashku me zëvendësguvernatorin Fusha, morën pjesë në takimin themelues (virtual) të Grupit Drejtues për Implementimin e SEPA-s, nën udhëheqjen e drejtorëve gjeneral të Drejtorisë së Zgjerimit (DG NEAR, z. Koopman dhe Drejtorisë për Stabilitet dhe Shërbime Financiare (DG FISMA), Berrigan, me pjesëmarrjen e guvernatorëve të bankave qendrore të Ballkanit

Perëndimor dhe Moldavisë, si dhe Këshillit Evropian të Pagesave (EPC), Bankës Qendrore Evropiane (ECB) dhe Bankës Botërore (WB). Qëllimi i themelimit të këtij grupi është ta ndjekë zbatimin e projektit të zgjerimit të zonës gjeografike të SEPA, si një forum për shkëmbimin e përvojave, informacioneve dhe bashkëpunimin për t'i paraqitur çështjet e rëndësishme të zbatimit të këtij projekti. Në vijim të zhvillimeve që dalin nga plani i Rritjes së

Bashkimit Evropian, nisma për themelimin e grupit drejtues nga Drejtoria e Zgjerimit (DG NEAR) e Komisionit Evropian, vjen pas një serie të takimeve të nivelit të lartë dhe grupeve teknike të vendeve të Ballkanit Perëndimor, në kuadër të projektit të Modernizimit të Sistemeve të Pagesave të Ballkanit Perëndimor, ku edhe Republika e Kosovës u përfaqësua nga Banka Qendrore, projekt ky i financuar nga Bashkimi Evropian dhe zbatuar nga



Banka Botërore në koordinim mbështetjen e qeverive të me Këshillit të Bashkimit shteteve në kuadër të Rajonal (RCC), me Procesit të Berlinit.

## ASK-ja publikon të dhënat për tregtinë e jashtme: Deficit tregtar prej 17,5 % në dhjetor 2024

EPOKA E RE Qendresa RAMA

PRISHTINË, 24 JANAR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin dhjetor 2024.

Të dhënat nga tregtia e jashtme të mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej 17,5 % në muajin dhjetor 2024, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 561,5 milionë eurosh, krahasuar me deficitin prej 477,7 milionë eurosh në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 11 %.

Eksporti i mallrave në muajin dhjetor 2024 kishte vlerën 69,6

milionë euro, ndërsa importi 631,1 milionë euro, që është një rritje prej 6,5 % për eksport, si dhe një rritje prej 16,2 % për import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 20,3 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 14,9 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 11,5 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 7,3 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 59,8 % e përbëjnë produktet minerale etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore të importit: 16,6 % e përbëjnë produktet minerale; 13,1 % e përbëjnë



makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12,7 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 12,4 % e përbëjnë mjetet e transportit; 7,7 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj.

Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 23,6 milionë euro, ose rreth 34 % e eksporteve të përgjithshme, me një rritje

prej 26,6 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (10 %), Austria (5 %), Holanda (2,8 %) etj. Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 23,6 milionë euro, ose rreth 34 % e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 26,6 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (10 %), Austria (5 %), Holanda (2,8 %) etj. Eksportet e Kosovës me vendet e CEFTA-s arritën në 33,2 milionë euro, ose 47,7 % të eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 19 %. Partnerë kryesorë për eksport nga vendet e CEFTA-s ishin: Shqipëria (21,6 %), Maqedonia e Veriut (14,8 %), Serbia (5,5 %), Mali i Zi (4,8 %).

Importet nga vendet e CEFTA-s arritën në 99,6 milionë euro, ose 15,8 % të importeve të përgjithshme, me një rritje prej (44,1 %). Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import ishin: Maqedonia e Veriut (5,9 %), Shqipëria (5,5 %), Serbia (3,1 %). Eksportet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 12,7 milionë euro, ose 18,3 %. Si partnerë më të rëndësishëm nga këto vende për eksport ishin: Zvicra (7,4 %) dhe ShBA-ja (3,5 %).

Importet e Kosovës me vendet e tjera të botës arritën në 261,7 milionë euro, ose 41,5 %. Vendet me pjesëmarrje më të lartë për import në këtë grup ishin: Turqia (13,8 %) dhe Kina (13 %).

## Mbi 137 milionë euro për rehabilitimin dhe modernizimin e njësisë A3 në Termocentralin Kosova A

PRISHTINË, 24 JANAR - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka shpallur të premtën tenderin për fazën I të projektit kapital "Rehabilitimi dhe modernizimi i njësisë A3 në Termocentralin Kosova A". Përmes këtij projekti synohet të rritet kapaciteti i prodhimit dhe të ndikojë në përmirësimin mjedisor të Njësisë A3.

Kryeministri Albin Kurti ka thënë se ky projekt është investimi më i madh në kapacitetet gjeneruese në KEK që nga ndërtimi i termocentraleve tona. "Mbi 137 milionë euro për rehabilitimin dhe modernizimin e njësisë A3 si asnjëherë më parë, duke



paguar çdo cent nga fitimi i të qeverisjes sonë dhe të arritur për më pak se katër vjet udhëheqjes së re korporative.

Ky projekt është investimi më i madh në kapacitetet gjeneruese në KEK që nga ndërtimi i termocentraleve tona. Me këtë investim Bllokut A3 po ia zgjasim jetën për 20 vjet; Rrisim kapacitetin nga rreth 120 - 140 MW në 215 MW; Shtojmë orët e punës nga rreth 5400 orë në vit në 7700 orë në vit; Dyfishojmë prodhimin vjetor nga rreth 700 mijë MWh orë në 1.5 milion MWh; Si dhe përmirësojmë efikasitetin mjedisor sepse A3-shi i rehabilituar do të përdorë gati 30 % më pak thëngjill dhe me teknologjinë e standardet bashkëkohore, do të pakojë për mbi 50 % dromcat, oksidet e

azotit e dyoksidin e sulfurit që nxjerr gjatë prodhimit", ka thënë Kurti.

Ai i ka falënderuar punonjësit, menaxhmentin dhe bordin e KEK-ut, ekipin e Ministrisë së Ekonomisë, USAID-in për përkrahje teknike dhe të gjithë që kanë kontribuar duke bërë të mundur këtë projekt e këtë investim.

Ndërsa ministrja e Ekonomisë, Artane Rizvanolli, nënvizoi se vitet e ardhshme do të jenë sfiduese pasi, siç tha ajo, një kohë termocentralet do të jenë jashtë funksionit. Megjithatë, ka shtuar se rezultatet e procesit rehabilitues të termocentralit do të jenë pozitive.

## Daut Haradinaj: Faturat e rrymës me çmime astronomike janë dëshmi e abuzimit kriminal të bandës energjetike

PRISHTINË, 24 JANAR - Kandidati për deputet i AAK-së, Daut Haradinaj, ka reaguar në "Facebook" në lidhje me faturat e rrymës që po shpërndahen këtë muaj.

Ai ka thënë se faturat e rrymës kanë ardhur me çmime astronomike dhe janë dëshmi e abuzimit kriminal të bandës energjetike. "Nëse ka pasur ndonjëherë abuzim

me popull, është kjo që po ndodh tani nga kjo qeveri. Faturat e rrymës që po shpërndahen sot me çmime astronomike janë dëshmi e abuzimit kriminal të bandës

energjetike. Urgjent duhet me u ngrit i madh e i vogël me e ndalu këtë shkatërrim. Ne paguajmë për GEN-in serb. Ky është krim dhe kjo është arsyeja se pse u



ndërpre projekti për termocentralin e ri", ka thënë Haradinaj.



# 'Squid Game'. Sa të vërtetë ka loja që pushtoi botën?



Që nga momenti kur "Squid Game" pushtoi botën, një pyetje ka përndjekur miliona shikues: A është kjo seri e bazuar në një histori të vërtetë? Me një premisë kaq tronditëse – lojëra vdekjeprurëse ku njerëzit luftojnë për mbijetesë në emër të argëtimit të pasurve – është e lehtë të kuptohet se si thashethemet dhe mitet filluan të qarkullojnë me shpejtësi. Por sa ka të vërtetë pas gjithë kësaj?

**Miti: Lojërat e "Squid Game" ndodhën vërtet në vitin 1988**

Një nga pretendimet më të përhapura është se "Squid Game" është frymëzuar nga ngjarje reale që ndodhën në Korenë e Jugut gjatë vitit

1988, i njëjti vit kur Seuli ishte mikpritës i Lojërave Olimpikë. Sipas këtij miti, lojërat u zhvilluan në mënyrë të fshehtë për të argëtuar elitën e pasur. Madje, kanë qarkulluar foto dhe video në rrjetet sociale, disa prej të cilave të krijuara me inteligjencë artificiale, që përpiqen të mbështesin këtë histori.

**Fakti: Një ngjarje historike, por jo lojëra vdekjeprurëse**

E vetmja lidhje reale mes vitit 1988 dhe "Squid Game" është fakti se në seri përmendet që lojërat nisën atë vit. Megjithatë, ka një ngjarje historike që mund të ketë ngjallur një farë lidhjeje të pavullnetshme: në vitet 1980, qeveria koreane ndërmoi një

fushatë për "pastrimin" e qyteteve të mëdha përpara Lojërave Olimpikë. Për të fshehur varfërinë dhe numrin e madh të të pastrehëve nga sytë e botës, shumë njerëz u ndaluan dhe u mbyllën në institucione të ashtuquajtura, "qendra ndihme sociale".

Një nga këto qendra, Brothers Home, ishte një vend ku ndodhën shkelje masive të të drejtave të njeriut. Raportimet tregojnë për keqtrajtime, abuzime dhe shfrytëzim të punës së detyruar. Struktura u mbyll në vitin 1987 pas një skandali të madh publik, dhe përgjegjësit u nxorrën përpara drejtësisë. Kjo ngjarje përfaqëson një faqe të errët të historisë koreane, por nuk ka lidhje me lojëra vdekjeprurëse, si ato të paraqitura në "Squid Game".

**Flet krijuesi**

Sipas krijuesit të serisë, Hwang Dong-hyuk, ideja për "Squid Game" lindi gjatë krizës financiare globale të vitit 2008. Ai u frymëzua nga situata e njerëzve që, për shkak të borxheve dhe varfërisë, ishin të gatshëm të bënin gjithçka për të përmirësuar jetën e tyre. Ai ndërthur konceptin e lojërave vdekjeprurëse me idenë e pabarazisë ekonomike, duke e kthyer serinë në një alegori të fuqishme sociale. "Squid Game" huazon gjithashtu nga koncepti i vjetër i "battle royale" – një format që ka ekzistuar në shumë forma gjatë historisë, nga gladiatorët romakë deri te tregimet moderne.

**Çfarë është e vërtetë dhe çfarë është trillim?**

**Pra, le t'i ndamë gjërat qartë:**


**E vërtetë:** Në vitet 1980, në Korenë e Jugut ndodhën shkelje të rënda të të drejtave të njeriut në institucione si Brothers Home.

**Trillim:** Nuk ka pasur kurrë lojëra vdekjeprurëse të organizuara si ato në "Squid Game".

Krijuesi Hwang Dong-hyuk nuk e ka përmendur kurrë Brothers Home si frymëzim për serinë.

Mitet dhe keqkuptimet që qarkullojnë online shpeshherë janë sajesa, ndonjëherë të amplifikuara nga teknologji si inteligjenca artificiale. Megjithatë, ndonjëherë realiteti mund të jetë po aq tronditës sa trillimi. / bota.al





**EURO GLASS**  
SAINT-DONAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## Antwan Walker shpallet MVP në Superligë

Vëllaznimi po vazhdon të jetë në top formë, ku në këtë xhiro fitoi ndaj Proton Cable Prizrenit. Të dy basketbollistët më të mirë te vendasit ishin Antwan Walker dhe Jericole

Hellems. Walker kishte 22 pikë, tetë kërcime dhe një asistim, duke pasur indeksin 32, apo më të lartin në këtë xhiro, duke u shpallur MVP. Ndërkohë, Hellems kishte 18

pikë, 10 kërcime dhe tri asistime. Bashkimi fitoi ndaj Borës, derisa më i dalluari ishte Jayveous Mckinnis me 14 pikë, shtatë kërcime dhe tri asistime. Sigal Prishtina fitoi

derbin e kësaj xhiroje ndaj Trepçës në Mitrovicë, në një sfidë dramatike. Te bardhekaltrit më i miri ishte Tyrrel Tate me 24 pikë, një kërcim dhe dy asistime.

Golden Eagle Ylli shënoi fitore ndaj Pejës, duke u rikthyer te fitoret, ku te therandasit më i miri ishte Lis Shoshi me nëntë pikë, tetë kërcime dhe një asistim.

# Sot dy ndeshje, nesër derbi Prishtina - Peja



**PRISHTINË, 24 JANAR** - ProCredit Superliga vazhdon me superndeshje në fundjavë, ku zhvillohet xhiroja e 19, derisa kampionati vazhdon të bëhet shumë më interesant. Takimi i parë i kësaj xhiroje është ndërmjet Proton Cable Prizrenit dhe Trepçës, që zhvillohet në Mitrovicë. Takimi është shumë i vlefshëm për të dyja skuadrat. Prizrenasit janë në vendin e tetë me katër fitore e 14 humbje, derisa mitrovicasit në vendin e dytë me 12 fitore e gjashtë humbje. Të shtunën zhvillohet sfidë interesante ndërmjet Golden Eagle Yllit dhe Bashkimit, dy skuadra që së

fundi kanë bërë ndryshime në shtabin teknik dhe kanë ambicie të larta në këtë edicion të elitës. Therandasit kanë tetë fitore e dhjetë humbje, kurse portokallezinjtë në pozitën e parë me 13 fitore e pesë humbje. Derbi i kësaj xhiroje zhvillohet ndërmjet Sigal Prishtinës dhe Pejës, dy skuadra që kanë treguar formë shumë të mirë në vitin 2025. Dy skuadrat me traditë në basketbollin e Kosovës përballen në një sfidë interesante të dielën në kryeqytet. Të dyja skuadrat kanë nga dhjetë fitore e tetë humbje, ku pritet një përballje e baraspeshuar. Ndeshja e fundit

e kësaj xhiroje, por shumë e rëndësishme është ndërmjet Borës dhe Vëllaznimit. Bora ka pesë fitore e 13 humbje, derisa kuqezinjtë në formë shumë të mirë kanë dhjetë fitore e tetë humbje.

### PROCREDIT SUPERLIGA-JAVA 19

**Të shtunën takohen:**  
17:00 Proton Cable Prizreni - Trepça  
19:00 Golden Eagle Ylli - Bashkimi

**Të dielën takohen:**  
17:00 Sigal Prishtina - Peja  
19:00 Bora - Vëllaznimi

### SHKURT

#### Vdes trajneri i njohur i shenjëtarisë sportive në Kosovë, Ali Pllana

Ka vdekur Ali Pllana, kontribuuesi i madh i sportit në vend. I ndjeri ishte për shumë vjet kryetar i Federatës së Shenjëtarisë Sportive të Kosovës, themelues i këtij sporti, ish-shenjëtar dhe trajner. Kryetari i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka shprehur ngushëllime për vdekjen e të ndjerit. Ai tha se kontributi i Pllanës ishte i palodhshëm dhe përkushtimi ndaj "zhvillimit të shenjëtarisë sportive do të mbeten një trashëgimi e çmuar për brezat e ardhshëm". Ai ishte pjesëmarrës në cilësimin e trajnerit edhe në debutimin e Kosovës në Lojërat Olimpikë "Rio 2016" dhe në Lojërat Evropiane "Baku 2015".

#### Rashica në formacionin e javës në Ligën e Evropës

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës në futboll, Milot Rashica, është futur në formacionin më të mirë të javës në Ligën e Evropës pasi shënoi dy gola me Beshiktashin. Lojtari nga Kosova është futur në mesin e më të mirëve në Ligën e Evropës në uebfaqen e njohur "Sofascore". Ai është vlerësuar me notën e lartë 8.8. Rashica ishte protagonist i dy golave në minutat 17' dhe 60' derisa Beshiktashi mposhti Athletic Bilbaon me rezultat të thellë 4-1.

#### Ndahet nga jeta ish-gjyqtari i njohur i futbollit, Enver Qosa

Ka vdekur një prej kontribuuesve të mëdhenj të futbollit të Kosovës dhe ish-gjyqtari i njohur, Enver Qosa. Qosa ishte një figurë rëndësishme e futbollit të Kosovës, veçanërisht gjatë viteve të vështira të okupimit (1990-1999), por edhe pas luftës, si gjyqtar e më pas edhe si vëzhgues i gjyqtarëve. Ai i përkiste gjeneratës së Republikës, një periudhë kur sportistët dhe punëtorët sportivë, me guxim të jashtëzakonshëm, i dolën zot mëvetësimi të sportit dhe shtetndërtimit përballë okupuesit serb. Me ndarjen nga jeta të Enver Qosës, telegram ngushëllimi dërgoi edhe Federata e Futbollit e Kosovës.

## Gjyqtarët e Superligës në futboll mbajnë seminar para fillimit të sezonit pranveror

**PRISHTINË, 24 JANAR** - Gjyqtarët e Superligës së Kosovës në futboll po zhvillojnë seminarin përgatitor para fillimit të stinorit pranveror, ku po kombinojnë trajnimet teorike me fazën përgatitore praktike. Ligjëratat po udhëhiqen nga instruktori i UEFA-s, spanjolli David Fernandez Borbalan, i cili është fokusuar edhe në

diskutimet për përmirësimin e standardeve të ndarjes së drejtësisë në vendin tonë. Gjatë seminarit, përpos videorasteve me situata të ndryshme në ndeshje ndërkombëtare, janë analizuar edhe vendimet e marra nga gjyqtarët e Kosovës në ndeshjet e stinorit të kaluar, duke u rikthyer situatave të diskutueshme dhe kritereve të

vendimmarrjes, me qëllim që gabimet të shmangen dhe performanca të përmirësohet në stinorin e ri. Ky seminar shënon një hap të rëndësishëm për përgatitjen e gjyqtarëve, duke garantuar se ata do të jenë të gatshëm për sfidat e stinorit pranveror. Gjyqtarët e Superligës sot do t'u nënshtrohen testeve fizike.





## Ndeshja 'All Star' do të luhet në një format tjetër, dihen edhe pesëshet e dy konferencave

SAN FRANCISCO, 24 JANAR - NBA ka shpallur zyrtarisht pesë basketbollistët që kanë marrë më shumë vota për lojën "All Star", e cila do të organizohet në San Francisco në muajin shkurt. Titullarët nga të dyja konferencat u zgjedhën në bazë të 50 për qind të votave të tifozëve, ndërsa mediet dhe vetë

lojtarët kishin një peshë prej 25-përqindësh në përzgjedhje. 14 pjesëmarrësit e mbetur të takimit "All Star" do të zgjidhen nga trajnerët dhe emrat e tyre do të bëhen të ditur më 30 janar. Loja 'All-Star' në San Francisco do të luhet në një format të ri pasi do të luhen tri ndeshje dhe 24 lojtarët do

të ndahen në tri ekipe që do të përbëhen nga ish-yjet e NBA-së, Charles Barkley, Shaquille O'Neal dhe Kenny Smith. Skuadra e katërt do të jetë e mbushur me fillestarë dhe lojtarë që njihen si 'rising stars' apo yjet në rritje. Pesëshja e konferencës lindore përbëhet nga Giannis Antetokounmpo, Jalen

Brunson, Donovan Mitchell, Jayson Tatum dhe Karl-Anthoni Towns, ndërsa ajo perëndimore nga Stephen Curry, Kevin Durant, Shai Gilgeous-Alexander, LeBron James dhe Nikola Jokiq. Do të luhet me sistemin e gjysmëfinaleve dhe finaleve dhe duelet do të luhen derisa dikush të arrijë 40 pikë. All



Star do të fillojë të premten, më 14 shkurt dhe do të zgjasë deri të dielën, më 16 shkurt.

## Fisnik Gashi largohet nga FC Besa Peja, vjen Megzon Visoka

PEJË, 24 JANAR (ER) - Janë bërë ndryshime në shtabin teknik në skuadrën e Besa Pejës. Finik Gashi është larguar nga detyra e trajnerit, kurse në vend të tij është emëruar Megzon Visoka. Klubi pejan e ka falënderuar Gashin, i cili kontribuoi shumë që futbollit të rikthehet në qytetin e Pejës. "Klubi ynë dëshiron të falënderojë nga zemra trajnerin Fisnik Gashi për punën dhe angazhimin e tij të jashtëzakonshëm në rikthimin e futbollit në Pejë. Fisi ishte një ndër të parët që besoi në projektin tonë dhe u bë pjesë e këtij rrugëtimi të madh. Puna dhe përkushtimi i tij kanë lënë një gjurmë të pashlyeshme në klubin tonë dhe në zemrat e tifozëve. Për këtë, ne i jemi përjetësisht mirënjohës dhe i urojmë suksese të mëtejshme në karrierë. Kjo është shtëpia jonë dhe kështu do të jetë gjithmonë - të gjithë bashkë për të ndërtuar një të ardhme edhe më të ndritur!", thuhet në njoftimin e



FC Besa Peja.

Klubi pejan beson se e ardhmja e trajnerit Megzon Visoka do të sjellë energji të re në klubin e Besa Peja. "Pas përvojave të suksesshme si trajner i dëshmuar në klube si Vllaznimi, Drenica, Flamurtari dhe Ferizaj, tash është koha që ai t'i bashkohet klubit tonë. Në një qytet ku tradita dhe ngjyrat e verdhë e zi janë pjesë e

identitetit, FC Besa Peja mirëpret Megzon Visokën si pjesë të familjes sonë. Me vizionin e tij të qartë dhe përkushtimin ndaj futbollit, ne besojmë se do të sjellë energji të reja në këtë qytet që jeton dhe frymon për futbollin. Mirë se vjen në familjen tonë të madhe, Megzon! 100 herë Besa, Besë!", thuhet, ndër të tjera, në njoftimin e kubit nga rrafshi i Dukagjinit.

## Lakersat mundin kampionët e Bostonit



LOS ANXHELOS, 24 JANAR - Lakersat arritën një fitore të rëndësishme në fushën e vet ndaj Bostonit me rezultatin 117-96, duke konsoliduar pozitën në zonën "play-off" në Perëndim. Sfidë e komanduar nga kalifornianët, ku Davisi realizoi 24 pikë, Reavesi 23 dhe Jamesi 20, një treshe që bëri dallimin në fushë.

Surprizon Dallasi, që mundi me shifrat 121-115 kryesuesit e Oklahomas. Dinwiddie me 28 pikë e Irvingu me 24 pikë u dalluan për miqtë, duke i bërë të pavlefshme 64 pikët e dyshes Shai - Williams. Rikthehet te fitorja edhe skuadra e Golden State, që mundi me shifrat 131-106 Chicagon, ndeshje ku u dallua

stoli i vendasve, nga ku erdhën 73 pikë. Nuk zhgënjeu ekipi i Milwaukee, që falë 29 pikëve të Lillardit dhe 25 të Antetokounmpos, mundi me shifrat 125-96 Miami. Ndeshje të mirë bëri edhe San Antonio, që mundi me rezultat 140-111 Indianan (Wembanyama 30 pikë), ndërsa Denveri mundi me rezultat 132-123 Sacramenton, ku u dallua Jokiqi me një "triple double" (35 pikë, 22 rebounde e 17 asistime).

### REZULTATET

Indiana - San Antonio	110-140
Orlando - Portland	79-101
Atlanta - Toronto	119-122
Milwaukee - Miami	125-96
Oklahoma - Dallas	115-121
Denver - Sacramento	132-123
Golden State - Chicago	131-106
Lakers - Boston	117-96
Clippers - Washington	110-93

## Vasseur: Besojmë te Hamiltoni, duam t'u japim pilotëve tanë një makinë të shpejtë

Koha e prezantimeve ka përfunduar te Ferrari, që ka nisur punën për të përgatitur një makinë të shpejtë për dy pilotët e saj. Në krah të Charles Leclerc këtë vit do të jetë Lewis Hamiltoni, shtatë

herë kampion bote në Formula 1. Këtë javë piloti britanik bëri prezantimin dhe ka provuar një Ferrari, ndërkohë që në fabrikë punohet për të qenë gati për mesin e marsit, kur nis sezoni i

ri. Drejtori sportiv i "kokëkuqes", Frederic Vasseur, shpreson shumë këtë sezon. "Pilotët bënë disa xhiro për t'u ambientuar, për ta gjetur sadopak ritmin dhe të

mësohen me pistën. Ishte, gjithashtu, një ngrohje e dobishme për të gjithë ekipin. Tani do të presim deri në testet dimërore", ka thënë Vasseur. "Tani shpresojmë që të gjithë komponentët të bashkohen

dhe të formojmë një makinë të shpejtë e fituese. Po punojmë shumë që t'u japim pilotëve një makinë konkurruese, që të na japë të gjithëve gëzime. Tifozët e meritojnë", ka deklaruar Vasseur.

### SHKURT

#### Nagelsmanni nënshkruan kontratë të re me Gjermaninë deri në Euro 2028

Julian Nagelsmann ka zgatur qëndrimin e tij si trajner i kombëtares gjermane pas nënshkrimit të një kontrate të re që do ta mbajë atë në krye të ekipit deri në Kampionatin Evropian 2028. Nagelsmann, i cili mori drejtimin e Gjermanisë pas shkarkimit të Hansi Flick në vitin 2023, ka arritur të rikthejë një frymë optimizmi dhe stabiliteti në ekipin që po përballë me kritika të ashpra për paraqitjet e dobëta. Nën drejtimin e tij, Gjermania ka treguar përmirësime në performancë, duke shënuar rezultate pozitive në ndeshjet miqësore dhe në përgatitjet për turnetë e ardhshme. Përkundër fillimit të tij të mirë, detyra e Nagelsmannit do të jetë sfiduese, duke përfshirë rindërtimin e një skuadre konkurruese dhe përmirësimin e pritshmërive të larta të një kombi që ka një histori të pasur suksesi në futbollin ndërkombëtar.

#### Garcia emërohet trajner i Belgjikës

Francezi Rudi Garcia është emëruar trajner i Belgjikës. 60-vjeçari zëvendëson italianin Domenico Tedesco, i cili u shkarkua javën e kaluar pas më pak se dy vitesh në post. Puna e fundit e Garcias ishte në skuadrën e Serisë A, Napoli, por ai u shkarkua pas vetëm 16 ndeshjesh në krye më 2023. Ai do të paraqitet zyrtarisht në një konferencë shtypi të premten. Para se ta merrte detyrën në Napoli, Garcia, i cili, gjithashtu, ka drejtuar Lillen, Marseillen dhe Lyonin, dhe ka kaluar tre vjet te Roma, pastaj mori drejtimin e Al Nassrit në Ligën Pro Saudite më 2022. Ai u largua nga klubi me marrëveshje të përbashkët pas 10 muajsh në krye. Belgjika, e cila renditet e teta në renditjen botërore të FIFA-s, përballë me Ukrainën në "play-off" të Ligës së Kombeve në mars, shkruan BBC.

#### Van Dijk: Të gjithë kanë frikë kur luajnë ndaj Liverpoolit

Kapiteni Virgil van Dijk mendon se fjalët e mira që thuhet për Liverpoolin, si skuadra më e mirë në Evropë, janë një vërtetim për mënyrën se si trajneri Arne Slot i bën ata të luajnë. Kapiteni i "The Reds" mendon se këto fjalë janë më se të merituar për një ekip që po dominon edhe në Premierë Ligë. Kjo deklaratë e Van Dijkut vjen pas fitores së shtatë në shtatë ndeshje të luajtura në Ligën e Kampionëve këtë sezon. "Unë mendoj se këto rezultate konfirmojnë se jemi në rrugën e duhur për të arritur ato objektiva që i kemi vënë vetes", ka thënë Van Dijk. "Ne punojmë në çdo ndeshje kaq shumë për të qenë një ekip shumë i vështirë për t'u mposhtur. Kur trajnerët e tjerë na lavdërojnë jo vetëm për mënyrën se si sulmojmë, por edhe për mënyrën se si mbrojmë në grup, kjo është një shenjë e mirë dhe meritë për të gjithë punën e palodhur që kë bërë secili nga ne", ka shtuar Van Dijk.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCES, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT  
AGJENCIA PËR ARSIM DHE AFTËSIM PROFESIONAL DHE ARSIM PËR TË RRITUR  
AGENCIA ZA PROFESIONALNO OBRAZOVANJE I OSPOSOBLAVANJE I OBRAZOVANJE ZA ODRASLE  
AGENCY FOR VOCATIONAL EDUCATION AND TRAINING AND ADULT EDUCATION

Nr:216/1  
Datë: 24.01.2025

## SHPALLJE KONKURSI

**Për regjistrimin e kandidatëve të gjeneratës së gjashtë për nivelin e 5-të, të kualifikimit “Këshilltarë për Karrierë” në Qendrën e Kompetencës – Prizren**

### 1. Kushtet e përgjithshme për regjistrimin e kandidatëve për regjistrimin e kandidatëve për nivelin 5 sipas Kornizës Kombëtare të Kualifikimeve (KKK), në Qendrën e Kompetencës në Prizren,

Të drejtë aplikimi kanë:

- 1.1 Kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punësimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zyre e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);
- 1.2 Kandidatët të cilët kanë përfunduar shkollimin e mesëm të lartë, shkollimin universitar (niveli 4 i kualifikimit ose më lartë).
- 1.3 Kandidatët të cilët e kanë mbaruar arsimin jashtë Kosovës, obligohen ta bëjnë nostrifikimin, barasvlerësimin e diplomave dhe dëftesave në MASHTI dhe pastaj të konkurrojnë për regjistrim.

### 2. Ofrimi i kualifikimit

Baza e ofritit të kualifikimit është Qendra e Kompetencës në Prizren si Institucion i akredituar nga Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve (AKK)

### 3. Përfitimet për kandidatët

Të gjithë kandidatët të cilët me sukses e përfundojnë këtë kualifikim, do të pajisen me certifikatë të nivelit V për “Këshilltarë në karrierë” sipas standardeve të AKK

### 4. Kreditë

Kualifikimi për “Këshilltarë në karrierë” zgjat një 240 orë mësimore – gjashtë javë trajnimi, ku sipas KKK Kualifikimi Kombëtar Profesional (D) me 12 Kredi të Arsimit dhe Aftësimi Profesional.

### 5. Pagesa për kualifikim

Sigurimi i cilësisë së kualifikimit bëhet nga AKK dhe AAAPARR. Të gjithë kandidatët të cilët pranohen për këtë kualifikim janë të obliguar që në afat prej 3 ditëve para se të fillojnë ligjëratat, të paguajnë shumën prej 450 (katër qind e pesëdhjetë) Euro.

### 6. Dokumentet e nevojshme për konkurim

Kandidatët për të konkuruar për regjistrim në kualifikimin e nivelit 5, “Këshilltarë në karrierë” duhet të paraqesin këto dokumente:

- ✓ Aplikacionin e cila merret Qendrën e Kompetencës Prizren;
- ✓ Kopja e letërnjoftimit
- ✓ Diplomën e shkollimit të mesëm të lartë,
- ✓ Diplomë të shkollimit universitar,
- ✓ CV
- ✓ Diploma dhe certifikata tjera
- ✓ I gjithë dokumentacioni duhet të prezantohet si kopje ndërsa origjinalet për verifikim i sjellin vetëm kandidatët të cilët do të pranohen.

### 7. Afati i paraqitjes së dokumenteve, vendi dhe shpallja e rezultateve

Paraqitja e dokumenteve bëhet prej datës 25 janar 2025 deri 31 janar 2025

Paraqitja e dokumenteve bëhet në Qendrën e Kompetencës Prizren, Lagjja Dardania pn, 20000 Prizren.

Lista e kandidatëve të pranuar shpallet më 03 shkurt 2025

Pagesat bëhet para se të filloj trajnimi me datë 04-05-06 shkurt 2025

Kthimi i dokumenteve për kandidatët, të cilët nuk janë pranuar do të bëhet pas shpalljes së rezultateve.

Kandidatët e refuzuar në bazë të kriterëve për regjistrim kanë të drejtë që brenda 24 orëve, nga koha e shpalljes së rezultateve të paraqesin ankesë në Qendrën e Kompetencës Prizren

### 8. Kriteret e regjistrimit

Përparësi kanë kandidatët, Individë që punojnë në sektorin e arsimit dhe punësimit publik dhe privat (mësimdhënës, stafi i qendrave për karrierë, këshilltarët në zyre e punësimit, kompanitë e rekrutimit, ofruesit e trajnimeve);

### 9. Kuotat për pranim të kandidatëve

Do të pranohen gjithsejt 15 kandidat për grup.

### 10. Fillimi i trajnimit

Pjesa e pare e trajnimit fillon 10 shkurt – 21 shkurt 2025

Pjesa e dytë e trajnimit fillon 03 mars – 14 mars 2025

Pjesa e tretë e trajnimit fillon 24 mars – 04 prill 2025

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Berat Terpuni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Nexhmedin Nixha”. dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Elvis Kuzhnini B.I. NGA Gjakova shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 810107161.
- Kristjan Margegaj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha”.
- Mimoza Ahmeti nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë “Hysni Zajmi”.
- Ilmi Sadrija nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Pjetër Bogdani”.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.







## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

